



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. _____ prot.

Himarë, më 02.11.2021

Lënda : Kthim përgjigjeje kërkesës suaj të datës 27.10.2021.

Në vijim të kërkesës suaj të dates 27.10.2021 ardhur me postë elektronike, protokolluar në institucionin tonë me nr.4556.prot, datë 27.10.2021, lidhur me kërkesën për informacion për aktivitetet sportive, kulturore, panaire, festat lokale dhe festat që janë kthyer në traditë tashmë gjatë sezonit veror.Ju bëjmë me dije se të gjitha aktivitetet janë realizuar duke respektuar protokollet e anti-covid. Një pjesë e aktiviteteve që janë lokale parashikohen paraprakisht nga bashkia dhe miratohen në Këshillin Bashkiak, ndërsa një pjesë tjetër janësi organizim i jashtëm dhe bashkia është mbështetëse në organizim. Më poshtë do të gjeni listen e aktiviteteve :

NR	Emri i Festës	Përshkrimi
1	Dita E Athaliotsës	Dita e Athaliotsës është festa më e rëndësishme në qytetin e Himarës. Kjo festë nuk ka një datë të caktuar, por zhvillohet gjithmonë të premten e parë mbas pashkëve ortodokse. Të rinjtë e zonës, mbërijnë në manastir një natë më parë, ngrejnë kamping dhe presin banorët e tjerë ditën e nesërme. Në këtë ditë organizohen disa lojra të ndryshme si dhe banorët pjekin mish dhe kërcejnë valle.
2	Kapja e Kryqit	Kapja e kryqit është një festë e përvitshme e besimtarëve orthodoksë e cila zhvillohet në ditën e shën Fotonit. Në këtë fest një pjesë e të rinjve të Himarës ndeshen midis tyre se kush do të kapi kryqin e bekuar nga prifti.
3	DITËT E SHËN MERISË NË MANASTIRIN E ATHALIO TSES	E njohur si një prej datave më të rëndësishme të kalendarit ortodoks, kjo festë kremtohet në Manastirin e Athaliotsës me pjesëmarrje masive nga besimtarët dhe jo vetëm.
4	South Outdoor Festival	Ky festival organizohet nga Giz dhe Bashkia Himarë. është viti I katert I këtij Organizimi. Vitet e kaluara është organizuar në fshatin e Vunoit dhe në atë të Pilurit. Këtë vitë do të organizohet në fshatin e Borshit. Ky festival është I fokusuar tek sportet e natyrës(hiking, canoe, fishing, jeep safari, diving, etj). Qëllimi i këtij aktiviteti është promovimi i fshatrave të Himarës, hapja e sezonit turistik më herët si dhe gjallërimin e fshatrave të Himarës.

5	Porto-Palermo Festival 2021	<p>Një festival i ri artit bashkëkohor, po jo vetëm, “Porto Palermo festival 2021”, do të emocionojë me tingujt e muzikës përgjatë bregdetit të Jonit në Kalanë e Porto Palermos.</p> <p>Festivali vjen si projekt ide e violinistit shqiptar Olen Çezari ku do të marrin pjesë jo vetëm artistë vendas por edhe muzikantë të ardhur nga Italia, Spanja, Zvicra dhe Rumania. Në këtë festival vecohet pjesëmarrja e: Marsela Çibukaj, baritoni Gëzim Mushketa, këngëtari Italian Eden Loren fitues “Sanremo Young, Elina Duni, Daniele Di Bonaventura, Laura Bretan këngëtarja romune etj... Festivali i muzikës “Porto Palermo Festival 2021” do të zgjasë për një muaj, çdo fundjavë nga data 15 korrik për të vijuar edhe përgjatë muajit gusht për të gjithë artdashësit.</p>
6	Turtle fest 2021	3 Nete festival me muzike elektronike, me dj nderkombetare ne bregdetin e Drimadhes.
7	the element festival 2021	5 Nete festival me muzike elektronike ne plazhin e Lukoves. Ne kete festival do te marin pjese dj nderkombetare
8	Festivali Folklorik 'Bejka e Bardhe'	eshte nje festival Polifonik qe zgjat per nje periudhe tre ditore. Ky Festival zhvillohet ne fshatin e Pilurit dhe eshte viti I trete radhaz qe zhvillohet si festival, dhe qe e kthen kete si tradite e zones dhe ne vecanteri fshatin Pilur.
9	Nata e Polifonise	Grupi Polifonik I Himares jep koncert 2 here ne muaj gjate gjithë sezonit turistik ne vendndodhje te ndryshme si, qendra e qytetit te Himares, kalaja ne Himare Fshat, kalaja ne Porto Palermo, Kalaja e Sopotit, etj

Faleminderit për mirëkuptimin!

KRYETARI I BASHKISË
Jorgo Goro